



Pranuar / Dorezuar Primiçetor/Preceptor Received/Delivery	03.10.2022	viti Year	
Organ /Mjesta Organ./Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	5833/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.719/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardit Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.719/2022 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 03.10.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.719/2022 e datës 22.08.2022 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), më datë 19.08.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me datës 22.08.2022 nën shenjë A.nr.719/2022 me numër protokolli 4835/2022, me pretendimet ankimore që të obligohet organi i punësuar të zbatoj orarin e punës sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe



Infrastrukturës. Ndërsa Këshilli më datë 02.09.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 4835/2022 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin për pozitën Ciceron; Akt Emërimit të datës 19.09.2019 për ankuesen; Kërkesën me numër protokolli 2910/22 e datës 23.05.2022 nga ankuesja; Raporti nga konsulta datës 19.05.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Ciceron datës 19.10.2018; Emailin e datës 19.08.2022 nga ankuesja; Kërkesën për Përgjigje në ankesë e datës 25.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 02.09.2022; Formularin e evidencës së ardhjes në punës për datë 20.05.2022, 19.05.2022, 18.05.2022, 17.05.2022, 16.05.2022, 21.05.2022, 22.05.2022, 23.05.2022, 24.05.2022, 25.05.2022, 26.05.2022, 27.05.2022, 28.05.2022, 29.05.2022, 30.05.2022, 31.05.2022; Vendimin me Nr. 34/ AMMK/2021 i datës 26.05.2021; Kërkesën për pagesën e fundjavave e datës 15.06.2022 dhe 05.07.2022 nga nëpunësit e Shpellës së Gadimes; Lista për javën e tretë, katër dhe pestë të muajit maj 2022 për ankuesën; Emaili i datës 22.06.2022 nga ankuesja; Emailin e datës 29.06.2022, 20.07.2022, 01.09.2022 nga Emailin e datës 11.08.2022 nga

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesën e parashtruar nga ankuesja, është e pabazuar, **SEPSE**:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur që ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 19.09.2019 është e punësuar në pozitën "Ciceron, në Sektorin për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Tutje ankuesja më datë 15.06.2022 ka parashtruar kërkesë për pagesën e fundjavave tek Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës mirëpo që nuk ka marr përgjigje.

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që institucioni është i obliguar të zbatoj orarin e punës sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Rregullorja (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, respektivisht neni 4 paragrafi 1, përcakton se: "Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten", ndërsa paragrafi 5 i këtij neni përcakton se: "Në raste të veçanta, kur diktohet nga nevoja specifike të punës, institucionet të cilat kanë të punësuar mund të përcaktojnë një orar të ndryshëm nga ai në paragrafin 1 të këtij neni . Në çdo rast orari nuk mund të kalojë dyzet (40) orë punë në javë dhe 12 orë në ditë, ku përfshihet një (1) orë pushim". Po ashtu sipas nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, është përcaktuar se: "Në raste të veçanta, për shkak të rritjes së vëllimit të punëve apo nevojave emergjente, zyrtari publik mund të punojë jashtë orarit, apo të caktohet kujdestar, të punojë gjatë natës, gjatë festave zyrtare, apo gjatë fundjavës".



Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, konstatoi se Monumenti me Rendësi të Veçanta "Shpella e Gadimes", ka një rendësi të veçantë për trashëgimin kulturore të Kosovës, për faktin që është monument historik dhe i njëjti vizitohet nga shumë qytetarë të Republikës së Kosovës dhe qytetarë nga jashtë, andaj si rezultat i kësaj është nëpunësit e këtij institucioni për shkak të natyrës së punës punojnë edhe me orar të zgjatur po ashtu punojnë edhe ditëve të vikendit, andaj edhe puna jashtë orarit dhe vikendeve është e kuptueshme, këtë e dëshmojnë raportet e vijueshmërisë në punës për datë 21, 22, 28, 29 të muajit maj 2022 që kanë qenë ditë vikendi, ndërsa ankuesja më datë 30 dhe 31 maj 2022 ka shfrytëzuar si ditë pushimi edhe pse kanë qenë ditë e hane dhe martë.


Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e lartcekura, konstaton se institucioni për kohën sa nëpunësit civil punojnë jashtë orarit të përcaktuar sipas nenit 4 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, janë të obliguara që ndaj tyre të aplikohen me dispozitat e nenit 7 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Puna jashtë orarit kompensohet në masën pesëdhjetë për qind (50%) me kohë pushimi ose në masën pesëdhjetë për qind (50%) me shtesë page e llogaritur si më poshtë: 3.1. 30 % shtesë në orë për orë punë jashtë orarit; 3.2. 20 % shtesë në orë për orë kujdestarie; 3.3. 30 % shtesë në orë për orë pune gjatë natës; 3.4. 50 % shtesë në orë për orë pune gjatë ditëve të festave; dhe 3.5. 50 % shtesë në orë për orë pune gjatë fundjavës"*, në rastin tjetër zyrtari publik mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë për punë jashtë orarit sipas paragrafi 3 i këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi siç parashihet me paragrafin 4 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, po ashtu kompensimi i punës jashtë orarit apo ditëve të vikendit bëhet edhe në pajtim me nenin 11 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

Nga administrimi i provave të lëndës, ankuesja nuk ka sjellë ndonjë dëshmi se për cilat ditë të punës jashtë orarit të rregullt apo punës gjatë ditëve të vikendit kërkon kompensimin, po ashtu nuk ka sjellë dëshmi që në një formë apo tjetrën i janë shkelur të drejtat e saj, sepse në bazë të emialit të datës 11.08.2022 të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës konstatohet se për muajin maj janë kompensuar për ditët e punës jashtë orarit apo ditëve të vikendit.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, konstaton se nuk është vërejtur ndonjë diskriminim ndaj ankueses, rrjedhimisht edhe ankuesja por edhe autoriteti punëdhënës janë të obliguara që të zbatojnë në plotëni dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, kështu që pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.




**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.719/2022

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Ardita Haxhriqaj DEMI**  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Kryeshefit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

